

Nr. 01 Prot.

Datë, 16.09.2024

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGËTARE****“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k**

Sot më datë 16.09.2024, unë i nënshkruari, Mentor BALILAJ me vullnetin tim të lirë dhe të plotë në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” hartoj këtë Akt Themelimi të Shoqërisë “**I-BALILI-KONSTRUKSION-I**” sh.p.k si më poshtë vijon:

**1. FORMA LIGJORE**

“**I-BALILI-KONSTRUKSION-I**” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

**2. ORTAKU THEMELUES**

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare është: Mentor BALILAJ

**3. OBJEKTI**

Shoqëria do të krijohet me qëllim:

Ndërtim objekte civile, ekonomike, industriale, rrugë, ura, tunele, porte, aeroporte, ndërtime tokësore e detare, terminale, ndërtime hidroteknike, ujësjellësa, gazsjellësa, kalata, mole, argjinatura, etj. Ndërtimi i linjave elektrike, mbitokësore, ajrore, nëntokësore, kabllore për energjinë elektrike, linja fuqie dhe telekomunikacioni, nënstacione elektrike të larta e të mesëm, etj. Projektim, menaxhim e ndërtim, instalim, konfigurim i impianteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaike) dhe energjisë së erës (eolike). Projektme dhe studime urbanistike: projektme e ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore: veprimtari e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis, vlerësim ndikimi në mjedis (auditimi mjedisor): projektme interieresh: projektim peisazhi e sistemimi: studime e projektme

hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike e gjeoteknike, prova laboratorike dhe gjeologjike të materialeve të ndërtimit; projektim objekte civile, ekonomike, industriale, rrugë, ura, tunele, porte, aeroporte, struktura tokësore e detare, terminale, ndërtime hidroteknike, ujësjellësa, gazsjellësa, kalata, mole, argjinatura, etj; projektme të inxhinierisë elektrike e hidro-mekanike: projektme konstruktive: projektme restaurimi, projektme për trajtimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujrave. Shërbime konsulence dhe supervizion e mbikqyrje për fushat e mësipërme. Vlerësim pasurish të paluajtshme, ushtrim i veprimtarisë në fushën e Arkeologjisë. vëzhgim Arkeologjik, sondazh Arkeologjik, gërmim Arkeologjik, etj. Prodhim i materialeve të ndërtimit, inerteve, betonit të klasave të ndryshme, të parafabrikateve të betonit, prodhimin të asfaltit etj. Importimin dhe eksportimin e lëndëve të para të ndërtimit, mallrave të ndryshme, të makinerive e paisjeve, pjesëve të këmbimit, etj. Zhvillimin e veprimtarisë minerare me punime sipërfaqësore dhe nëntokësore, shfrytëzim i karrierve, punime me lëndë plasëse për përdorim civil. Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ndërtimit prishjeve dhe mbetjeve të ngurta urbane. Grumbullim dhe transport i mbetjeve nga ujrat e ndotura, mbetjeve të llumrave me përmbajtje hidrokarbure, etj. Transportin e mallrave për nevojat e veta dhe të tretëve brenda e jashtë vendit. Studim, projektim, prodhim, montim, tregëtim dhe zbatim i sinjalistikës rrugore vertikale e horizontale, ndricuese dhe jondricuese, vijëzime, barriera rrugore, etj. Mirëmbajtje, operim, menaxhim të objekteve civile, ekonomike, industriale, rrugë, ura, tunele, porte, aeroporte etj. Importi, eksporti, tregëtia me shumicë e pakicë e makinerive, pajisje e mallrave. Cdo veprimtari në fushën e ndërtimit, dhe cdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.



#### **4. SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë **“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k** do të jetë në adresën: “Kompleksi Garden Residence Turdiu, Kulla C, Zyra. 1, Kati 2, Rruga Andrea Kushi Nr.58, AL 1023”, Tiranë, Shqipëri

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj.

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me emrin e shoqërisë brenda saj.

#### **5. KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË**

Shoqëria **“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k** krijohet për të vepruar për sa kohë do ketë treg për shërbimet e ofruara prej saj.

Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

#### **6. KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i Shoqërisë **“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k** është në vlerën 100.000 Lekë.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose të pakësohet me Vendim Ortakut të vetëm të Shoqërisë / Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme me Ortakëve (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

#### **7. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME ORTAKËVE DHE PËRFAQËSUESI LIGJOR**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare **“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k** është edhe organi më i lartë i saj.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë do të jetë Mentor BALILAJ.

## **8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

**8.1** Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm i emëruar dhe i pandryshueshëm në përputhje me këtë statut për të gjithë kohëzgjatjen e shoqërise.

**8.2** Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit.

**8.3** Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

**8.4** Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 5 vjeçar për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së shoqërisë:

*Z. Mentor BALILAJ, shtetas shqiptar, , i datëlindjes 24.10.1979, lindur ne Vlore dhe banues në Tirane , mbajtës i pasaportes me numër BG8590018 dhe numër personal H91024039B lëshuar nga Ministria e Brendshme datë 20.11.2020*

## **9. PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

Prishja dhe likujdimi i shoqërisë tregtare mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, pavlefshmëria



e themelimit të shoqërisë të parashikuar nga ligji, për çdo shkak tjetër të vendosur me vullnetin e ortakëve të shoqërisë.

## 10. TË NDRYSHME

Akti i themelimit të shoqërisë u përpilua në 2(dy) ekzemplarë, njëra për tu dorëzuar pranë organeve kompetente dhe tjetra do të mbetet në dosjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë **“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k.**

Akti i themelimit të shoqërisë **“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k** nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“I-BALILI-KONSTRUKSION-I” sh.p.k**

**Mentor BALILAJ**